

Aplikim për vizë Schengen me qëllim udhëtim turistik në Gjermani

KUJDES: Vetë shtetasit shqiptarë nuk kanë nevojë për vizë hyrjeje për qëndrime turistike në hapësirën Schengen.

Për të aplikuar për vizë ju nevojitet një datë dhe orë takimi. Ju lutem rezervoheni përmes sistemit online të caktimit të takimeve.

Aplikimi është i mundur deri tre muaj përpara datës së planifikuar udhëtimit. Përpunimi i aplikimit zgjat **minimalisht tre ditë pune**. Ju rekomandojmë që këkesën për vizë ta dorëzoni jo më vonë se dy javë përpara nisjes së udhëtimit.

Dokumentet dhe dëshmitë duhet të paraqiten **në original dhe fotokopje**. Dokumentet origjinale do të kthehen sërish. Duhet mbajtur në konsideratë që të gjitha dokumentet e dorëzuara që nuk janë në gjermanisht ose anglisht, duhet të kenë bashkëngjitur përkthimin përkatës në gjuhën gjermane.

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit si dhe t'u përmbaheni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuar në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit.

Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:			
1.	Formularë aplikimi për vizë Schengen	Një formular i plotësuar dhe nënshkruar personalisht.	
2.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhet kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 60,00 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.	
3.	Fotografi pashaporte	1 fotografi biometrike për pashaportë , jo më e vjetër se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm.	
4.	Pashaporta	Pashaportë e vlefshme me afat vlefshmërie të mbetur prej të paktën tre muajsh përtej fundit të udhëtimit. Pashaporta /dokumenti i udhëtimit duhet të ketë të paktën dy faqe bosh dhe data e lëshimit të mos jetë më e hershme se 10 vjet. Fotokopje e të gjitha fletëve me të dhëna. Nëse keni: Fotokopje të vizave Schengen të tre viteve të fundit dhe viza të vlefshme apo të skaduara nga SHBA / Mbretëria e Bashkuar përfshirë këtu edhe vulat e hyrje-daljeve nga policia e kufirit.	

6.	Dëshmi për financa të mjaftueshme	Vërtetim nga llogaritë bankare të aplikuesit (p.sh. statements të tre muajve të fundit, vërtetim page, vërtetime depozitash bankare apo të të ardhurave nga pronat)	
7.	Siguracion shëndetësor	Siguracioni shëndetësor (në origjinal) duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë kohëqëndrimin e planifikuar dhe për të gjitha vendet Schengen. Ai duhet të mbulojë të gjitha shpenzimet, që do të mund të rezultojnë në rast të një kthimi për arsye mjekësore, të një trajtimi mjekësor urgjent, të një qëndrimi eventual në spital apo të vdekjes së aplikuesit/es gjatë kohës së qëndrimit. Mbulimi minimal duhet të jetë në vlerën e 30.000 eurove. Siguracioni shëndetësor në udhëtim duhet të mbulojë gjithë kohëzgjatjen e qëndrimit të planifikuar	
8.	Rezervim fluturimi dhe hoteli	Si dëshmi e udhëtimit dhe e akomodimit. Në rast se udhëtoni në vende të ndryshme lutemi të bashkëngjisni një tabelë përmbledhëse.	
9.	Leje qëndrimi shqiptare	Dëshmi që rezidenca e zakonshme është në Shqipëri dhe do të vazhdojë të jetë kështu edhe pas kthimit nga Gjermania	

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen dokumenta të caktuara të përmendura më sipër.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.